


KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale



Informim
Dhe
Privatësi

Nr.2

Dhjetor 2016

Përmbajtja

Editorial.....	faqja 3
Seminar mbi Median TAIEX—EU Projekt.....	faqja 4
Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim.....	faqja 6
E drejta për informim, Konferenca Rajonale Kukës.....	faqja 7
Marrëveshje bashkëpunimi KDIMDP—UT.....	faqja 8
Takime në universitete.....	faqja 9
Studimi në përfundim të fushatës ndërgjegjësuese “Privatësia dhe siguria e të dhënave gjatë përdorimit të rrjeteve sociale nga të rinjtë”.....	faqja 10
Google street view.....	faqja 12
Deleteme.al.....	faqja 12
Sweep Privacy Week, Bashkëpunimi ndërkombëtar GPEN.....	faqja 13
Takimi i 28 CHW në Podgoricë, Mali i Zi.....	faqja 14
Konferenca e 38-të Ndërkombëtare e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë.....	faqja 14
Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm.....	faqja 15

Revista “Informim Dhe Privatësi”

Përgatitet dhe botohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Adresa: Rr. e Kavajës, Nd. 80, H. I, K. 5, Tiranë.

Drejtues: Irma Arapi.

Redaksia: Alketa Kojra, Redi Skënderaj, Erald Mullaraj.

Print:

Botimet Onufri

Dhjetor 2016

Editorial

Të nderuar lexues!

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj numrin e dytë të Revistës “Informim Dhe Privatësi”. Zyra e Komisionerit përmbyll një tjetër vit të mbushur me sfida dhe arritje, disa prej të cilave janë të pasqyruara në këtë botim. Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit që garanton të drejtën e privatësisë dhe atë të informimit është njëkohësisht përpjekje për të ndryshuar mentalitetin shoqëror. Kultivimi i kulturës së transparencës dhe koncepti se çdo dokument zyrtar pikërisht se është i tillë është publik, mbetet objektiv edhe për vitin 2017.

Kontributi i Zyrës së Komisionerit në rrugën e integritetit u vlerësua maksimalisht nga partnerët tanë evropianë në Progres Raportin e vitit 2016 për Shqipërinë, duke konfirmuar edhe një herë këtë angazhim serioz. Forcimi i kapaciteteve administrative dhe mbështetja më e madhe financiare është prioritet për të adresuar sfidat e së ardhmes. Edhe partnerët tanë evropianë e kanë theksuar këtë çështje, duke e përfshirë pa hezitim atë në Progres Raportet e viteve të fundit. Rritja e njohurive teorike e praktike nëpërmjet trajnimeve, njëkohësisht, do të ndikojë në përmirësimin e standardeve të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve në vendin tonë.

Zyra e Komisionerit ka objektiva ambicioze për zbatimin e disa projekteve. Autoriteti ka aplikuar pranë Komisionit Evropian për akordimin e nivelit të mjaftueshëm/adekuat të mbrojtjes së të dhënave personale, si një instrument që garanton rritjen e standardeve në vendin tonë. Nga ana tjetër, hyrja në fuqi në maj të vitit 2018 të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave në vendet anëtare të BE, hap perspektivën e përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian në këtë fushë. Adresimi i këtyre problematikave është një sfidë konstante, njëkohësisht, pjesë e procesit integral të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Në fund, më lejoni t'ju uroj të gjithëve Gëzuar Vitin e Ri 2017!

BESNIK DERVISHI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe
Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Seminar mbi Median TAIEX—EU Project

29—30 Shtator 2016



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Instrumentin e Asistencës Teknike për Shkëmbimin e Informacionit të Bashkimit Evropian (TAIEX), organizuan në datat 29 dhe 30 shtator 2016, në Tiranë “Seminarin mbi Median dhe Përputhshmërinë me Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave”, me pjesëmarrjen e ekspertëve evropianë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe Medias nga Britania, Gjermania, Sllovenia dhe Lituania, si edhe ekspertë vendas. Seminarin e përshëndetën z. Besnik Dervishi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; z. Genc Pollo, Kryetar i Komisionit Parlamentar të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik; z. Gentian Sala, Kryetar i Autoritetet të Mediave Audiovizive; si dhe z. Stephen Stork, përfaqësuesi i Zyrës së Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë.

“Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta për informim, e lidhur shumë ngushtë me lirinë e shprehjes, nuk mund të jenë detyrime për t’u përmbushur vetëm nga Zyra e Komisionerit. Ky është një rrugëtim i përbashkët, për konsolidimin e një shoqërie demokratike e të bazuar mbi sundimin e ligjit” - theksoi në fjalën e tij z. Dervishi.



Në foto: z. Stephen Stork, z. Besnik Dervishi dhe z. Genc Pollo.

Kjo iniciativë u ndërmor si rezultat i detyrave të lëna në Progres-Raportin e vitit 2015 të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të problematikave të shkeljes së të drejtës për mbrojtje të të dhënave personale nga ana e Medias, me vëmendje të veçantë në të dhënat e të miturve, ashtu si edhe në strategjinë

2014-2017 të Zyrës së Komisionerit, për ndërgjegjësimin e aktorëve të fushës së medias në Shqipëri, për respektimin e standardeve kombëtare dhe evropiane të mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë.



Në dy ditë të Seminarit u trajtuan disa çështje me interes për mediat, të tilla si:

- korniza ligjore për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me gazetarinë në Shqipëri dhe në BE;
- rëndësia e Kodit të Etikës në media, integriteti profesional dhe gazetaria investigative;
- përparësitë dhe sfidat për ruajtjen e balancës mes gazetarisë së mirë dhe privatësisë së individit në komunitet;
- balancimin e të drejtës për privatësi dhe shkatërrimit të informacionit me interes publik;
- respektimin e të dhënave personale dhe privatësisë në Epokën Dixhitale (duke përfshirë edhe median dixhitale);
- përdorimin e kamerave të fshehta për qëllime të gazetarisë investigative;
- trajtimin e rasteve konkrete të shkeljes së privatësisë dhe në veçanti, mbrojtja e të dhënave personale e të miturve.

Pjesëmarrës në seminar ishin gazetarë nga mediat audiovizive, të shkruara dhe portaleve online; zëdhënës të Autoriteteve Publike, përfaqësues të shoqërisë civile, etj. Ky aktivitet informoi aktorët mediatikë mbi normat ligjore dhe standardet e Bashkimit Evropian, të kombinuar me një vështrim të përgjithshëm të kuadrit ligjor dhe praktikave kombëtare, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga mediat.

28 Shtator 2016

Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim



28 Shtatori është Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim. Kësaj iniciative promovuese për herë të parë këtë vit, iu bashkua edhe Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo ditë e veçantë përkoi edhe me 2-vjetorin e miratimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Me këtë rast, Zyra e Komisionerit nxit pjesëmarrjen qytetare në nismën “Qeverisje e hapur në veprim” nëpërmjet videoprojektimit në fasadën e Muzeut Historik Kombëtar me mesazhe ndërgjegjësuese.

Kësaj iniciative iu bashkuan dhe operatorët e telefonisë celulare të cilët shpërndanë mesazhin: *“Informimi Publik është një e drejtë për ty dhe një detyrim për zyrtarët. Kërko të drejtën tënde! 28 Shtator – Dita ndërkombëtare e të drejtës për informim”*.



Pamje nga projektimi në fasadën e Muzeut Historik Kombëtar

E drejta për informim

Konferenca Rajonale Kukës



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi në Kukës konferencën rajonale “E drejta për informim, autoritetet publike, koordinatori dhe programet e transparencës”. Ky aktivitet u zhvillua pas takimeve të mbajtura më herët në Berat, Gjirokastrë, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Shkodër. Konferenca njohu dhe trajnoi përfaqësuesit e strukturave të pushtetit vendor, si dhe ato të institucioneve qendrore në nivel vendor, me detyrimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Z. Besnik Dervishi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në fjalën e tij e vuri theksin në rëndësinë e nxitjes së kulturës së transparencës nga Autoritetet Publike, si domosdoshmëri për një administratë moderne, të përgjegjshme dhe efikase. Komisioneri, vlerësoi, se që nga hyrja në fuqi e ligjit 2 vjet më parë, institucioni ka reflektuar dhe zbatuar në punën e tij praktikën dhe eksperiencat më të mira evropiane, duke trajtuar një gamë të gjerë problematikash nga ankesat e qytetarëve. Vlen të theksohet fakti se shumica e këtyre ankesave janë zgjidhur me ndërmjetësimin e Zyrës së Komisionerit.

Z. Dervishi tha, se ka ardhur koha që programet e transparencës të përmirësohen, për të reflektuar specifikat e Autoriteteve Publike. Nga ana tjetër, institucionet duhet të forcojnë rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit.

Marrëveshja e bashkëpunimit midis

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Universitetit të Tiranës

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi dhe Rektori i Universitetit të Tiranës, z. Mynyr Koni, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve.



Në foto: z. Mynyr Koni z. Besnik Dervishi

Një nga pikat më të rëndësishme të kësaj marrëveshjeje është themelimi i Shkollës Dimërore “Informim dhe Privatësi”. Funksionimi i saj ka për qëllim, që njohuritë dhe problematikat në fushat e privatësisë dhe të së drejtës për informim, t’i trajtojë në mënyrë më të thelluar. Shkolla synon përgatitjen dhe njohjen e vazhdueshme, sidomos, të studentëve me risitë në këto dy drejtime. Si pjesë e aktiviteteve për kremtimin e Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, në muajin janar të vitit të ardhshëm do të zhvillohet për herë të parë edhe programi i kësaj shkolle.

Marrëveshja, ndër të tjera, parashikon aplikimin dhe zbatimin në praktikë të projekteve të përbashkëta. Dokumenti angazhon palët në shfrytëzimin e të gjitha mundësive për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve në ushtrimin e të drejtave të tyre. Gjithashtu, kjo marrëveshje synon që përmes mekanizmave institucionalë të adresojë nevojën e përmirësimeve në legjislacion në të dyja fushat.

Takime në universitete



Universiteti "Fan Noli" — Korçë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi takime me studentë dhe stafin akademik në Universitetin "Fan Noli" të Korçës dhe në Filialin e Sarandës të Universitetit të Tiranës. Këto aktivitete informuese kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për respektimin e të drejtave të qytetarëve dhe në njohjen e legjislacionin që garanton zbatimin e tyre.

Stafi i Zyrës së Komisionerit mbajti prezantime për përmbajtjen e ligjit "Për të drejtën e informimit" dhe atë "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Të pranishmit në takime u njohën me kompetencat e institucionit dhe veçanërisht, me procedurën e kërkesës dhe trajtimin e ankesave të qytetarëve. Njëkohësisht, u shpjeguan roli dhe funksionet e koordinаторit për të drejtën e informimit dhe përmbajtja e programit të transparencës së Autoriteteve Publike.

Në këto takime, u trajtuan edhe raste praktike të shkeljes së privatësisë dhe keqpërdorimit të të dhënave personale, si dhe u diskutua për shfrytëzimin e avantazheve që të ofron interneti, rrjetet e ndryshme sociale apo dhe moria e aplikacioneve. Të tilla takime u zhvilluan më herët gjatë vitit në univeristetet e Tiranës, Shkodrës, Elbasanit, Vlorës dhe Gjirokastrës.



Universitetit i Tiranës — Filiali Sarandë

Studim për nivelin e përdorimit të rrjeteve sociale nga grupmosha 15–18 vjeç

STUDIM MBI NIVELIN E PËRDORIMIT TË RRJETEVE SOCIALE NGA GRUPMOSHA 15 – 18 VJEÇ

Tiranë, Dhjetor 2016



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale realizoi gjatë vitit 2016 fushatën ndërgjegjësuese “Privatësia dhe siguria e të dhënave gjatë përdorimit të rrjeteve sociale”. U zhvilluan 36 takime në shkollat e mesme të përgjithshme në qytetet kryesore të vendit. Zyra e Komisionerit falenderon drejtuesit e DAR dhe këtyre shkollave për gatishmërinë dhe kushtet e krijuara për mbarëvajtjen e këtyre aktiviteteve. Gjatë këtyre takimeve u trajtuan raste konkrete të keqpërdorimit të të dhënave personale nga vetë të rinjtë, ndërsa, u njohën edhe me mjete e mënyra për të shmangur shkeljet e privatësisë dhe për minimizimin e ekspozimit të tyre ndaj rreziqeve online. Stafi i Zyrës së Komisionerit i informoi të pranishmit me aspekte të ndryshme për një qasje të sigurt në internet.

Nxënësve iu shpërnda një pyetësor për të identifikuar nivelin e përdorimit të rrjeteve sociale dhe sjelljen e kësaj

grupmoshe në raport me to. Pyetësori përfshin pyetje që kanë të bëjnë me të dhënat personale që vendosen në rrjet; numrin e miqve dhe kategoritë e informacioneve që ndahen me ta; nivelit të njohjes së politikave të privatësisë; problemet që mund të sjellin në jetën private përdorimi i rrjeteve sociale, njohuri për zgjidhjen e këtyre problemeve, etj.

Ky pyetësor ndihmon për të kuptuar më mirë se çfarë ndodh tek të rinjtë shqiptarë dhe cilat janë mënyrat më të efektshme për të rritur ndjeshmërinë e tyre për mbrojtjen e të drejtave në ambientin online dhe rritjen në tërësi të edukimit dixhital

Në total, atë e plotësuan 1063 nxënës nga 36 shkolla të mesme të përgjithshme të qyteteve të Tiranës, Durrësit, Vlorës, Elbasanit, Fierit, Beratit, Gjirokastrës, Lezhës, Shkodrës, Korçës, Kukësit, Lushnjës, Pogradecit, Tepelenës, Përmetit dhe Sarandës. Zyra e Komisionerit pas përpunimit të këtyre të dhënave, hartoi një studim mbi nivelin e përdorimit të rrjeteve sociale nga grupmosha 15–18 vjeç.

Nga ky studim u nxorrën disa konkluzione interesante për prirjet e përdorimit të rrjeteve sociale nga të rinjtë shqiptarë. Kjo grupmoshë ka tendencë të anëtarësohet në ato rrjete sociale të cilat janë aktualisht më në modë edhe në shkallë globale. Vlen të theksohet fakti se vjen gjithnjë në rritje si prirje përdorimi i telefonave të zgjuar — smartphone-ve.

Fushata ndërgjegjëse “Privatësia dhe siguria e të dhënave gjatë përdorimit të rrjeteve sociale”

Shkolla e mesme e përgjithshme “Hydajet Lezha”, Lezhë



Studimi jep informacion të bollshëm për sjelljen e të rinjve gjatë përdorimit të rrjeteve sociale, miqësitë, problemet që ata kanë hasur gjatë komunikimit, duke sjellë edhe shembuj konkretë për mënyrat që kanë përdorur për zgjidhjen e tyre. Megjithëse të vetëdijshëm për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale, nxënësit shpesh tregohen neglizhentë për masat e sigurisë gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Kjo konstatohet lehtësisht edhe nga përgjigjet e dhëna, ku mosleximi apo


moskuptimi i politikave të privatësisë është në nivele shqetësuese.

Gjetjet e studimit synojnë të iniciojnë një diskutim gjithëpërfshirës mes institucioneve shtetërore. Adresimi i problematikave të kësaj grupmoshe, të konstatuara edhe në këtë pyetësor, është i rëndësishëm për ta kthyer temën e privatësisë në pikë referimi, kur flasim për përdorimin e sigurt të internetit dhe rrjeteve sociale. Diskutimi mund të jetë, padyshim, në rrafshin legjislativ dhe të hartimit të politikave strategjike, ashtu si edhe në atë të zbatimit të masave konkrete, në radhë të parë në rritjen e nivelit të edukimit dhe ndërgjegjësimit të nxënësve, por padyshim, edhe të mësuesve. Besojmë se avantazhet e aksesit në internet janë të shumta dhe përdorimi i tij dhe pajisjeve të lidhura me të, apo çdo lloj mjedisi dixhital, do të rrisë në mënyrë të drejtë përfitimet, duke mos anashkaluar problematikat. Një nga sugjerimet më të vlefshme ishte që iniciativat e kësaj natyre duhen zhvilluar më shpesh, duke bashkëpunuar me sa më shumë aktorë të sistemit arsimor shqiptar. Veçanërisht, edukimi me parimet e privatësisë është i nevojshëm me nxënësit e shkollave 9-vjeçare, ku ka një përceptim për më shumë probleme edhe për shkak të moshës më të vogël.



Shkolla e mesme e përgjithshme “Leonik Tomeo”, Durrës

Studimin do ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare në internet të Zyrës së Komisionerit: www.idp.al.



Prej muajit prill të këtij viti kompania amerikane Google ka realizuar fotografimin 360° të rrugëve të qyteteve kryesore, si dhe të zonave turistike e historike të vendit.

Në muajin nëntor, Google filloi ofrimin e shërbimit Google Street View në Shqipëri. Kjo kompani ka bashkëpunuar me Zyrën e Komisionerit që përpunimi i të dhënave nëpërmjet këtij aplikacioni të realizohet në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale për respektimin e të drejtave të shtetasve shqiptarë në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Në njoftimin e kompanisë Google për lançimin e shërbimit është cituar edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi - *“Privatësia nuk mund të jetë opsion, Zyra e Komisionerit e garanton këtë të drejtë”*.

Deleteme.al

Ekzistojnë fotografi të mia nga festa të cilat janë publikuar online. Si t'i fshij?

Postova diçka në rrjetet sociale tek të cilat nuk kam besim të plotë. Si ta fshij tani?

Këtyre pyetjeve por dhe shqetësimeve të tjera lidhur me të dhënat tuaja personale të publikuara online do t'i jepni përgjigje përmes një nisme të re që do të lançohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

DeleteMe.al është një faqe web, ku qytetarët mund të gjejnë informacionin teknik të nevojshëm për t'u çregjistruar ose fshirë llogaritë dhe të dhënat e tyre personale në rrjetet sociale më të njohura online. DeleteMe u vjen në ndihmë qytetarëve të të gjitha moshave që mund të preken nga shkeljet e privatësisë online.

DeleteMe do të ofrojë këshilla dhe udhëzime për personat që ndeshen me materiale që shkelin privatësinë e tyre në Internet, të tilla si foto të publikuara pa lejen e tyre, profile të rreme ose të dhëna personale të pasakta. Është e rëndësishme të kuptohet se DeleteMe nuk ka kompetenca (mandat) të kërkojë fshirjen e të dhënave të qytetarëve nga Interneti. Ky shërbim ka për qëllim të vetëm këshillimin dhe udhëzimin për mënyrat se si qytetarët do mund të kërkojnë fshirjen apo korrigjimin e të dhënave të tyre në Internet.

Faqja DeleteMe do të përmbajë artikuj shpjegues dhe informues lidhur me rreziqet mbi privatësinë, të drejtat që burojnë nga ligji dhe adresa kontakti për ofruesit kryesorë të shërbimeve online si (Facebook, Instagram, Linked In, Twitter, YouTube, SnapChat, Google, Viber, etj.). Por DeleteMe.al do të jetë më tepër se një faqe web. Qytetarët do të mund të kontaktojnë me telefon, email apo formën e kontaktit online, për çdo paqartësi apo pyetje rreth shërbimit.

Sweep Privacy Week

Bashkëpunimi ndërkombëtar GPEN

Sweep Privacy Week është projekt i përvitshëm i Rrjetit Ndërkombëtar të Agjencive Ligjzbatuese të Privatësisë, i njohur ndryshe me akronimin GPEN. Kontrolli online i aplikacioneve dhe pajisje Internet of Things (IoT— Interneti i Gjërave) synon të verifikojë përputhshmërinë e tyre me rregullat e privatësisë. Projekti u realizua në muajin prill të këtij viti, njëkohësisht nga 25 autoritete ku u kontrolluan gjithsej 314 aplikacione. Rezultatet e kontrollit u publikuan në fund të muajit shtator.

Zyra e Komisionerit kontrolloi 3 aplikacione për smartphone të kontrolluesve shqiptarë dhe një pajisje IoT (fitness tracker - gjurmues fitnesi) të një kontrolluesi jashtë territorit tonë. Nga rezultatet e kontrollit rezultoi se një prej aplikacioneve (kontrollues shqiptar) ka mangësi serioze në 4 prej këtyre treguesve:

- shpjegime për grumbullimin/përpunimin dhe përhapjen e të dhënave;
- arkivimin dhe masat e sigurisë;
- kontaktet në rastet e shfaqjes së problematikës me privatësinë;
- si realizohet shkatërrimi i të dhënave.

Ndërsa, tre aplikacionet e tjera kanë më shumë informacione në politikat e privatësisë, por kanë elementë që duhen përmirësuar, për t'u ofruar konsumatorëve garanci në përpunimin e drejtë të të dhënave të tyre personale.

Rezultatet e kontrollit ndërkombëtar u publikuan gjatë muajit shtator dhe evidentuan se në rang botëror aplikacionet dhe pajisjet IoT:

- nuk japin informacion për përdorimin e të dhënave - 59% e rasteve;
- nuk japin informacion për ruajtjen e të dhënave - 68% e rasteve;
- nuk japin informacion për fshirjen e të dhënave - 72% e rasteve;
- nuk japin kontakte për komunikimin e problemeve të privatësisë - 38% e rasteve.

Për më shumë informacion mund të lexoni raportin përfundimtar në faqen zyrtare të Komisionerit www.idp.al



Takimi i “28 Case Handling Workshop” në Podgoricë, Mali i Zi



Në takimin e 28-të Punës së Rasteve të Veçanta morën pjesë përfaqësues nga 19 Autoritete të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, anëtarë të Konferencës Evropiane. Seminari u zhvillua në Podgoricë gjatë muajit tetor dhe Zyra e Komisionerit mbajti prezantimin me temë “Impakti i medias në jetën private”. Në të u trajtuan problematika me përpunimin e të dhënave pa pëlqimin e individit, mungesa e rregullores së posaçme për masat e sigurisë, përhapjen të dhënave, etj. Në aktivitet u prezantuan raste konkrete të shkeljes së privatësisë në fusha, si telekomunikacioni; në sektorin bankar dhe financiar; në mjekësi; transferimin ndërkombëtar të të dhënave; përdorimin e sistemeve të video-survejitimit; publikimin e të dhënave në rrjetet sociale, etj. Një nga çështjet me rëndësi që u diskutua në këtë takim ishte edhe zbatimi i Rregullores së re të Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Bashkimin Evropian.

Konferenca e 38-të Ndërkombëtare e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave

Konferenca Ndërkombëtare e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC) zhvilloi në Marakesh të Marokut punimet në edicionin e 38-të të saj, me moton “Sfidat e reja të privatësisë”. Një nga çështjet e rëndësishme që u trajtuan në këtë Konferencë ishte zbatimi i unifikuar i Rregullores së re të Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (GDPR) në BE. Kreu i Njësisë së Mbrojtjes së të Dhënave në Drejtorinë e Përgjithshme të Drejtësisë (DG Justice) në Komisionin Evropian tha se “synimi është të kemi nivel të mjaftueshëm, i cili të jetë i barasvlefshëm kudo, ndërkohë që BE do të intensifikojë dialogun ndërkombëtar për të lehtësuar më tej qarkullimin e të dhënave”. Në këtë edicion të Konferencës u miratuan këto dokumente:

- Rezoluta për miratimin e një kuadri ligjor ndërkombëtar për Edukimin mbi Privatësinë;
- Rezoluta mbi zhvillimin e indikatorëve të rinj të Rregullores së Mbrojtjes së të Dhënave;
- Rezoluta mbi mbrojtësit e të drejtave njerëzore;
- Rezoluta mbi bashkëpunimin ndërkombëtar për zbatimin e ligjeve të privatësisë



Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm

Përfaqësues të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përfunduan programin Tailor-made Training (TMT). Ai u mundësua nga “The Netherlands Fellowship Programme të agjencisë EP-Nuffic, pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës dhe që u zbatua nga Universiteti Vrije Amsterdam. Gjatë trajnimit referuan akademikë



studiues, përfaqësues të Autoritetit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, juristë dhe veprimtarë të organizatave jo qeveritare.

Stafi i Zyrës së Komisionerit ndoqi leksione mbi Rregulloren e re të Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian, që hyn në fuqi në maj të 2018 dhe përmirësimet në raport me Direktivën 95/46, ishin ndër temat kryesore të trajnimit. Po ashtu, u prekën nëpërmjet prezantimit të rasteve konkrete çështje si: procesi i transferimit ndërkombëtar të të dhënave dhe vendimet e



“Informim Dhe Privatësi”



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Rruga e Kavajës, Nd. 80, H. I, K 5, Tiranë

www.idp.al

info@idp.al

+355 42237200

0800 2050